

BREAKING NEWS

"NJË HAP MADHOR NË MARRËDHËNIET MES DY VENDEVE" / NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË



AKTUALITET

I përfshirë në 11 ngjarje kriminale, arrestohet në Tiranë i shumëkërkuari i rrezikshëm, kërcënoi me armë edhe djalin e deputetit të PS (EMRI+DETAJE)

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
30 SHTATOR 2020



Arrestohet në Tiranë i shumëkërkuari, Lajden Kadilli, i njohur ndryshe me nofkën “Lypeni”.

Pas një operacioni të mirëorganizuar, Kadilli është arrestuar në ambientet e një kompleksi në Tiranë.

Policia e kishte pikasur prej kohës se ai jetonte në këtë zonë, dhe mbrëmjen e djeshme një grup agentësh, kanë vendosur të ndërhyjnë me qëllim arrestimin e tij. Por Lajden Kadilli, ka “nuhatur” lëvizjet e shpeshta të agentëve dhe menjëherë u largua me vrap.

Teksa po vraponte Kadilli hodhi në tokë edhe një pistoletë, por që flanë ndërhyrjes në kohë të forcave ‘Shqiponja’ ai u arrestua.

Kush është Lajden Kadilli?


Lajden Kadilli, është një personazh shumë i njohur i botës së krimit në Durrës. Ai është shpallur në kërkim nga policia, pasi ka kanosur me armë djalin e deputetit të PS në Durrës, Spartak Braho dhe i ka thyer xhamin e makinës.

Në muajin gusht të vitit 2019, Kreshnik Braho u sulmua me armë nga Kadilli. Në momentin që ndodhi ngjarja, djali i deputetit ishte në shoqërinë e dy fëmijëve të mitur që ndodheshin në makinë me babain e tyre, por fatmirësisht nuk pësuan asnjë lëndim. Që prej kësaj date e deri pasditen e djeshme, Lajden Kadilli, figuronte si person me kartelë të “Kuçe” në regjistrat e policisë kriminale.


Por një muaj më vonë, më 11 shtator të vitit 2019, Kadilli u bë sërish pjesë e një tjetër ngjarjeje kriminale. Ai u shpall në kërkim nga Gjykata e Tiranës, vendim i cili u dha nga gjyqtari, Altin Abdiu, pasi prokuroria e Tiranës e akuzon 26-veçarin për “Vrasje me paramendim” mbetur në tentativë në dëm të Gentian Rrahmanit dhe “Mbajtjes pa lejë të armëve luftarake dhe municionit”. Kjo dosje është administruar nga prokurori i Tiranës Robert Kote, dhe tani pas arrestimit, Kadilli do të dalë para gjykatës, për t’u njohur me masën e sigurisë.

Kadilli ka qëndruar për më shumë se pesë vite me radhë në kërkim, ndërkohë çështjet penale kundër tij nëpër gjykata, janë zgjidhur me dënime të buta, duke e vënë në shërbim prove. Por ai asnjëherë nuk është arrestuar nga policia.


Më të lexuarat




Jemi në Tetor, por e pazakontë çfarë po ndodh me motin në vend/ Shikoni pamjet në bregdetin e Durrësit (VIDEO)




"Do të dërgohen edhe në Shqipëri", epidemiologu Alimehmeti tregon hapin e madh që po arrihet: Shumë lajm i mirë miqtë e mirë! Tregon si do funksionojë metoda më e re




Vrasja e biznesmenit të njohur shqiptar. Familjarët japin versionin për ngjarjen e rëndë: Ju lutem pranoni këtë njoftim si të vetmen të vërtetë të plotë në lidhje me rastin tragjik. Ja pse vdiq vëllai i tij




U dëmtua nga tërmeti, IKMT vendos 130 kg eksploziv për shembjen e pallatit 14-katësh në Durrës




Vdes babai i deputetit shqiptar, zyrtari jep lajmin e hidhur




Arrestohet 62-vjeçari në Tropojë, ajo çfarë iu gjet në banesë e fundosi




“Çmimi për kilogramë ka thyer rekord këtë vit”, Artan Hoxha sfidon Ramën dhe publikon fotot me parcelat e drogës: Përshëndetje zoti kryeministër nga veriu i Shqipërisë




Çmenduri në autostradën e Saukut/ Policia Rrugore kap makinën duke ecur me shpejtësi 202 km/h (VIDEO)




Temperaturat do të shkojnë deri në 29 gradë, ja surprizat e motit për ditën e sotme



Sherr dhe të shtëna me armë zjarri gjatë natës në Elbasan, policia blindon qytetin (Detajet e para)



Gjendet i varur burri në Tiranë



“Heu sa pak paskan qenë”, Artan Hoxha nxjerr deklaratën e bujshme të Donald Lu

Mesazhe Promocionale


Gossip



“Prej tre ditësh nuk jam mirë”/ Almeda Abazi dhe djali i saj bëjnë testin për Covid-19! Ja rezultati i tamponit


Stina e vjeshtës është periudha më e favorshme për t&...

Opinione




SKËNDER SADRI KAPITI

Politikanët shqiptarë dhe marrëdhëniet me Turqi...




A ILMI QAZIMI

Fatkeqësisht po, por mundemi që...



PANAJOT ZOTO

Po transporti ndërqytetës është në vëmendjen e ...



BARDHYL BEJKO

Çeku i bardhë gjashtë mujor, si premtim përrall...

LEXO OPINIONE TE TJERA